



Fabrika e Miellit, Rr. e Kavajës,  
Tiranë, Albania,  
Tel: 355 4 224846  
Fax: 355 4 240157

**VENDIM**

i

**KESHILLIT MBIKQYERS**  
Nr 1 date 21 Maj 2001



Keshilli Mbykqyres i Shoqerise Anonime BLOJA sh.a – Tirane, i perbere nga:

<i>Agron Haxhiymeri</i>	<i>Kryetar (aksioner)</i>
<i>Genc Cela</i>	<i>Nen kryetar (perfaqesues i shtetit)</i>
<i>Irena Kedhi</i>	<i>Anetar (aksioner)</i>

U mblodh sot me date 21maj 2001,dhe pasi mori ne shqyrtim propozimin per shtimin e numrit te aksioneve dhe ritjen e vleres se kapitalit nepermjet investimit te propozuar,

*Vendosi:*

Aprovimin per kryerjen e investimeve per rreth 6 milion dollarë, ne BLOJA sh.a –Tirane ku do te perfshihen:

- *Rritja e kapacitetit magazinues te silosave te lendeve te para deri ne 11.000 ton grure.*
- *Rritja e kapacitetit te repartit te pastrimit ne 400 ton/24 ore.*
- *Rritja e kapacitetit te repartit te blojes ne 300 ton/24 ore.*
- *Pershtatja e silosave te pa perdoreshme te grurit ne silosa mielli dhe hite.*
- *Automatizimi i sistemit te ambalazhimit te produkteve te gateshme dhe modernizimi i menyres se ngarkimit.*
- *Vendosja e sistemit te ri elektrik (panelet) ne fabrike.*
- *Kompjuterizimi i te gjithe proceseve te punes.*




Agron Haxhiymeri

BLOJA sh.a

Kryetar i Keshillit Mbykqyres

*GENC CELA*

*NIKRYETAR I KESHILLIT MBIKQYRES*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT TIRANË  
Nr. 14253 Vend.

V E N D I M  
I G J Y Q T A R I T T Ë V E T Ë M

Në Tiranë, sot më dt. 1/10, 2001, unë, gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë, mbasi shqyrtova kërkesën e paraqitur nga Drejtori i Pergjithshem i Shoqërisë "BLOJA" SHA, Tiranë, Z. Fuad Haxhiymeri,

K o n s t a t o v a :

Me Vendimin Nr. 14253 dt. 21.03.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, është regjistruar Shoqëria "BLOJA" SH.A., me seli në Tiranë, me kapital te perbashket midis aksionerëve privatë që kanë 70 përqind të aksioneve dhe Shtetit Shqiptar që ka 30 përqind të tyre.

Kapitali i Shoqërisë sipas Statutit është 296.200.000 lekë, i ndarë në 296.200 aksione me vlerë nominale prej 1000 lekë për aksion.

Me Vendimin Nr. 1, dt. 21.05.2001 të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë është miratuar kryerja e investimeve në këtë shoqëri. Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve, në mbledhjen e saj dt. 04.06.2001, ka miratuar kryerjen e investimit dhe zmadhimin e kapitalit nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja. Ministria e Ekonomisë Publike dhe e Privatizimit, që ka në pronësi 30 përqind të aksioneve, me shkresën 4099/2, dt. 07.06.2001, ka miratuar investimet e reja teknologjike në Shoqërinë "BLOJA" SHA duke i kaluar si zmadhim kapitali.

Sipas aktit të ekspertimit dt. 18.07.2001 të ekspertes kontabël Donika Abedini, kapitali i Shoqërisë zmadhohet nga 296.200.000 lekë në 1.209.658.000 lekë, pra me një shtesë prej 913.458.000 lekë. Mbas zmadhimit të kapitalit, pjesëmarrja në të do të jetë: Aksioneri Privat 92.7 % dhe Aksioneri Shtet 7.3 %.

Kërkesa është e drejtë dhe, si e tillë, duhet pranuar.

P ë r k ë t o a r s y e :

Në mbështetje të Ligjës Nr. 7667, dt. 28.1.1993, "Për regjistrin tregtar"

V E N D O S A :

Depozitimim e Vendimit Nr. 1, dt. 21.05.2001, të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë të Shoqërisë "BLOJA" SH.A.; process – verbalin e datës 14.06.2001 të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve, shkresën Nr. 4094/2 dt. 07.06.2001 të Ministrisë së

Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, aktin e ekspertimit për zmadhimin e kapitalit dt. 18.07.2001 si dhe pasqyrën e makinerive dhe paisjeve të importuara.

Kapitali i Shoqërisë "BLOJA" SH.A. zmadhohet nga 296.200.000 lekë në 1.209.658.000 lekë. Mbas zmadhimit të kapitalit, pjesëmarrja në të do të jetë: Aksioneri Privat 92.7 % dhe Aksioneri Shtet 7.3 %.

Aktet e mësipërme depozitohen pranë Regjistrimit Tregtar, duke bërë ndryshimet përkatëse.

Gjyqtare

*Enxhela Bex*  
*Fajloal*

## **AKT-EKSPERTIMI**

### **PER ZMADHIMIN E KAPITALIT TE SHOQERISE ANONIME "BLOJA" SH.A.Tirane**

Me kerkesen e shoqerise tuaj, une Donika Abedini ,me funksionin e Ekspertit Kontabel te Autorizuar , kam marre persiper kryerjen e Ekspertimit per zmadhimin e kapitalit te shoqerise tuaj sipas vendimeve te marra nga Asambleja e Aksionereve dhe ne perputhje me kerkesat e ligjit "Per shoqerite Tregetare" dhe te ligjit "Per kontabilitetin".

Per realizimin e detyres se ngarkuar une kam kryer te gjitha ekzaminimet ne perputhje me Standartet e njohura e te pranuar te Auditimit. Keto Standarte kerkojne qe une te kryej shqyrtimet dhe ekzaminimet e nevojeshme per te konkluduar me siguri mbi gjendjen ekonomiko- financiare te shoqerise dhe shkaqet per zmadhimin e kapitalit.

Ne perfundim te punes time une konstatova sa me poshte:

Shoqeria Anonime "BLOJA" sh.a. eshte themeluar ne baze te vendimit te Gjykates Tirane Nr. 14253 date 21.03.1996 si shoqeri anonime me kapital te perbashket midis aksionereve privat qe kane 70 % dhe Shtetit Shqiptar me 30 % te tij.

Objekti i veprimtarise se saj eshte prodhim mielli dhe nenprodukte te saj si hime e gezhuta .  
Kapitali i shoqerise sipas statutit te saj eshte 296 200 000 leke e ndare ne 296 200 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksioner .

Me vendim te Keshillit Mbikqyres Nr.1 date 21.05.2001 eshte vendosur aprovimi per kryerjen e investimeve per rreth 6 milion dollare ,ne Bloja sh.a. Tirane,ku do te perfshihen :

\* Rritja e kapacitetit magazinues te silosave te lendeve te para deri ne 11 000 ton grure.

\* Rritja e kapacitetit te repartit te pastrimit ne 400 ton/ 24 ore.

\* Rritja e kapacitetit te repartit te blojes ne 300 ton/ 24 ore.

\* Pershtatja e silosave te paperdorshem te grurit ne silosa mielli dhe hime.

\* Automatizimi i sistemit te ambalazhimit te produkteve te gateshme dhe modernizimi i menyres se ngarkimit.

\* Vendosja e sistemit te ri elektrik ( panelet) ne fabrike.

\* Kompjuterizimi i te gjithë proceseve te punes.

Shoqeria " BLOJA " sh.a. me shkresen e saj te dates 30 Maj 2001 i eshte drejtuar Ministrise se Ekonomise Publike dhe Privatizimit me funksionin e pronarit shtet duke kerkuar aprovimin e kryerjes se investimeve ne kete shoqeri.

Ministria Ekonomise Publike e Privatizimit me shkresen nr. 4099/2 date 07.06.2001 ka miratuar investimet e reja civile dhe teknologjike ne shoqerine " BLOJA " SH.A. te cilat do te kalojne ne shtese kapitali .

Me daten 14.06.2001 ne mbledhjen e Asamblese se jashtezakoneshme te Aksionereve te " BLOJA " Sh.a. eshte miratuar programi per kryerjen e investimeve te reja civile dhe teknologjike ne "BLOJA " Sh.A. prej 6.5 milion dollare te financuara nga aksioneri Agron Haxhiymeri dhe cilat do te kalojne ne shtese kapitali .Gjithashtu eshte miratuar qe si rezultat i ketij investimi perqindja e aksionereve te shoqerise " BLOJA " Sh.A. Tirane eshte :

Aksioner privat 93 %

Aksioner shtet 7 %

Per te gjykuar mbi kushtet qe do te merren parasysh per zmadhimin e kapitalit,une si eksperte jam bazuar ne Bilancin kontabel te vitit 2000 dhe ne dokumentacionin faktik qe disponon shoqeria per makinerite dhe paisjet qe jane cdoganuar per llogari te kesaj shoqerie , te cilat kapin shifren 6 301 145 dollare me nje vlere prej 913 358 931 leke.  
Per te gjitha keto vlere eshte pergatitur edhe nje pasqyre e cila eshte e bashkangjitur.

Duke patur parasysh sa me siper kapitali i shoqerise nga 296 200 000 leke arrin ne 1 209 658 000 me nje shtese prej 913 458 000 leke ose 913 458 aksione me vlere nominale 1000 leke/aksioni ndersa pjesemarrja ne kapital arrin :

Aksioner privat 92.7 %  
Aksioner shtet 7.3 %

Numuri i pergjithshem i aksioneve eshte 1 209 658 leke me vlere nominale 1000 leke per aksion.

Gjate kontrollit te ushtruar nga ana ime rezultoi se Bilanci i shoqerise " BLOJA " sh.a. dhe dokumentacioni per kryerjen e investimeve eshte i sakte ,eshte kontabilizuar sipas rregullave dhe pasqyron realitetin .

Per sa parashtrova me lart jap miratimin tim si eksperte kontabile e autorizuar per zmadhimin e vleres se kapitalit te shoqerise " BLOJA " sh.a. nga 296 200 000 leke ne 1 209 658 000 leke.

Eksperte kontabel e Autorizuar  
Dr. Donika Abedini

Tirane me, 18 Korrik 2001

*Donika*

